



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 7, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I  
KOMPLEKSIT TURISTIK “SAN PIETRO”, KOMUNA ISHËM, QARKU DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Vendimit nr. 13 datë 04.07.2013 të KKT-së, “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, Komuna Ishëm, Qarku Durrës”, si dhe Vendimit nr. 3 datë 03.12.2003 të KRRTRSH, “Për ristudimin urbanistik të zonës turistike të Gjirit të Lalzit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për projektin “Ndërtimi i Kompleksit Turistik “San Pietro”, Komuna Ishëm, Qarku Durrës, me subjekt kërkues shoqërinë “Concord Investment” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të Kompleksit Turistik;
  - c. Harta me fazat e zhvillimit të Kompleksit Turistik.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Komuna Ishëm për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE EKKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**Z. ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**